



KËSHILLI I EVROPËS E DËNON VANDALIZMIN E TËRËSIVE KULTURE

Këshilli i Evropës në Prishtinë dënon fuqishëm vandalizmin e kohës së fundit dhe nxjerrjen e materialeve në Kishën e Lindjes së Virgjëreshës së Shenjtë në Obiliq dhe në tërësitë tjera serbe ortodokse. Institucionet e Përkohshme të Vetëqeverisjes (IPVQ), Kisha Ortodokse Serbe dhe Institutet për Mbrojtjen e Monumenteve në Kosovë dhe Serbi po punojnë së bashku përmes Komisionit Implementues të Rindërtimit (KIR) në drejtim të mbrojtjes dhe rindërtimit të 34 tërësive në Kosovë. Vandalizmi i vazhdueshëm i këtyre tërësive është në konflikt direkt me të gjitha përpjekjet e ndërmarrura nga IPVQ dhe bashkësinë ndërkombëtare për ruajtjen e trashëgimisë kulturore në Kosovë. Këto sulme të vandalizmit promovojnë një imazh negative të Kosovës dhe e vonojnë progresin drejt një të ardhme paqësore.

Këshilli i Evropës nxit bashkësitë që ti respektojnë këto ndërtesa dhe mbështetë Qeverinë e Kosovës në zotimet e saj. Barabar, Këshilli i Evropës shpreson se IPVQ dhe komunat do të përpiqen që të gjejnë mekanizma më efikas për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore në Kosovë.